



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 649/5 Prot.

Tiranë, më 20.05.2025

V E N D I M

Nr. 124, datë 20.05.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 95, datë 18.04.2025¹, e znj. F.Rr kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike/lidhjes familjare²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën datë 30.04.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *“Urdhri nr. 526, datë 07.04.2025 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, është një urdhër i paligjshëm dhe abuziv, në shkelje të rregullave që rregullojnë marrëdhëniet e punës në RSH dhe në shkelje të kushteve të parashikuara në kontratën individuale të punës dhe tërësisht i paprovuar.*

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar nga ankuesja me shkresën datë 30.04.2025.

² Për shkak të kandidimit të z. E.Rr, djali i xhaxhait i bashkëshortit të saj, në koalicionin opozitar “Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” si përfaqësues i partisë Agrare Ambientaliste, si dhe angazhimit të kунatit të saj z. E.Rr (vëllai i bashkëshortit) në përkrahje të kushëririt të tij, në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11.05.2025.

- Referuar Certifikatës Familjare datë 23.04.2025 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 404, të Bashkisë Kavajë, vërtetohet se znj. F.Rr është bashkëshortja e z. S.Rr, i cili është djali i xhaxhait të kandidatit për deputet z. E.Rr.

Pretendoj se urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK për largimin tim nga detyra ka arsye politike, të cilat lidhen me kandidimin e djalit të xhaxhait të bashkëshortit tim, shtetasit E.Rr si kandidat për deputet i Partisë Agrare Ambientaliste, në koalicionin “Shqipëria Madhështore”.

Fakti që vëllai i bashkëshortit tim (kunati im) dhe djali i xhaxhait të bashkëshortit tim kanë angazhime politike në zgjedhjet e 11 majit 2025, angazhime në kandidimin brenda koalicionit “Shqipëria Madhështore”, si dhe ngacmimet e vazhdueshme ndaj meje, gjatë orarit të punës, pas angazhimit politik të tyre, presionet dhe provokimet periodike, më kanë krijuar bindjen e plotë se largimi im nga puna është për arsye politike. Pretendimi im bëhet i besueshëm dhe tërësisht i provuar po të shikohet nxitimi që ka patur pala e paditur për të më larguar nga puna, pa zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Punës për rastin konkret. Largimi im nga puna ditët e çeljes së fushatës elektorale nga partitë politike, ditë kur u bë shpallja publike e djalit të xhaxhait të bashkëshortit tim si kandidat për deputet, e bën vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të paligjshme, të dënueshme, diskriminuese dhe në shkelje flagrante.

Drejtori i Përgjithshëm i ASHK në rastin konkret më ka vendosur në një pozitë të pafavorshme dhe diskriminuese, për shkak të kandidimit për deputet të familjarëve të mi, në një forcë politike kundërshtare (opozitare) me forcën politike përfaqësuese e së cilës është drejtori i përgjithshëm.

Gjithashtu ndër vite, nuk kam pasur asnjë vërejtje as nga drejtuesit e ndryshëm të ASHK Kavajë dhe as nga drejtuesi i ASHK Durrës-Kavajë-Krujë, për mosrespektim të orarit apo sjellje jo etike në punë.

Njëkohësisht ju bëj me dije që me raportin e paaftësisë në punë nr. 892, datë 27.03.2025, akt i cili është lëshuar elektronikisht në portalin e-albania, kam qenë në regjim shtrati nga data 27-28.03.2025”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 649/3, datë 14.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në vijim, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën “*Dëftesë Komunikimi*” nr. 12735 Akti, datë 07.05.2025, të protokolluar me tonën me nr. 769, datë 13.05.2025, ka njoftuar Komisionerin me Kërkesë-Padinë dhe provat shkresore të depozituara nga pala paditëse (F.Rr).

Në Kërkesë Padinë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 14.04.2025, me paditës: F.Rr, dhe subjekt të paditur: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është njoftuar si palë e tretë.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesja në këtë proces, Komisioneri vëren se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së ankueses drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesja, pranë Gjykatës, ndër të tjera, parashtrohet se:

“..... Ngre pretendimin që urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK për largimin tim nga detyra ka arsye politike, të cilat lidhen me kandidimin e djalit të xhaxhait të bashkëshortit tim, shtetasit E.Rr si kandidat për deputet i Partisë Agrare Ambientaliste, në koalicionin “Shqipëria Madhështore.

Në nenin 9 të Kodit të Punës është parashikuar shprehimisht ndalimi i diskriminimit për arsye politike.

Fakti që vëllai i bashkëshortit tim (kunati im) dhe djali i xhaxhait të bashkëshortit tim kanë angazhime politike në zgjedhjet e 11 majit 2025, angazhime në kandidimin brenda koalicionit “Shqipëria Madhështore”, si dhe ngacmimet e vazhdueshme ndaj meje, gjatë orarit të punës, pas

angazhimit politik të tyre, presionet dhe provokimet periodike, më kanë krijuar bindjen e plotë se largimi im nga puna është për arsye politike.

I/E nderuar Gjyqtare/e, pretendimi im bëhet i besueshëm dhe tërësisht i provuar po të shikohet nxitimi që ka pasur pala e paditur për të më larguar nga puna, pa zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Punës për rastin konkret. Largimi im nga puna ditët e çeljes së fushatës elektorale nga partitë politike, ditë kur u bë shpallja publike e djalit të xhaxhait të bashkëshortit tim si kandidat për deputet, e bën vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të paligjshme, të dënueshme, diskriminuese dhe në shkelje flagrante.

Pala e paditur, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK në rastin konkret më ka vendosur në një pozitë të pafavorshme dhe diskriminuese, për shkak të kandidimit për deputet të familjarëve të mi, në një forcë politike kundërshtarë (opozitare) me forcën politike qeverisëse, përfaqësuese e së cilës është drejtori i përgjithshëm.

Në bazë të Vendimit nr. 19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Vendimit nr. 33, datë 13.09.2007 të Gjykatës Kushtetuese, i takon palës së paditur, ASHK të provojë shkakun e arsyeshëm të largimit nga puna (barra e provës).

Kalimi i barrës së provës është parashikuar edhe në nenin 36 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në bazën ligjore ankuesja në mes të tjerash i është referuar dhe ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka parashtuar të njëjtat fakte dhe prova për veprimet e paligjshme dhe diskriminuese të bëra nga ana e punëdhënësit/ASHK, lidhur me largimin e saj nga puna, për shkak të bindjes politike/lidhjes familjare, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për

pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 95, datë 18.04.2025, të znj. F.Rr, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj³.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “*Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të paraqesë mendimin me shkrim në Gjykatë, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 95, datë 18.04.2025, të paraqitur nga subjekti ankues, F.Rr kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 145, datë 26.07.2023 dhe nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.